



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 150, datë 30.09.2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 17, DATË 28.04.2015 “PËR
FUNKSIONIMIN DHE MBAJTJEN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 7, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 17, datë 28.04.2015 “Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike dhe Licencimit dhe Sekretari i Bordit, për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

Në Rregulloren nr. 17, datë 28.04.2015 “Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 5.4, e nenit 5, riformulohet si vijon:

“5.4 Pas marrjes së miratimit të Kryetarit të Bordit për thirrjen e mbledhjes së Bordit, por jo më vonë se pesë ditë pune përpara datës së mbledhjes, përveç rasteve kur ka urgjencë dhe mbledhjet e Bordit mbledhen me afat njoftimi më të shkurtër, Sekretari i Bordit i dërgon anëtarëve të Bordit me postë elektronike ose me shkrim, njoftimin dhe rendin e ditës për mbledhje si dhe materialet që do të shqyrtohen. Data e njoftimit të anëtarit të Bordit do të konsiderohet data e dërgimit të njoftimit.”

2. Në nenin 5, shtohet pika 5.8 si më poshtë vijon:

“5.8 Mbledhjet e Bordit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik duke siguruar komunikimin me zë ose figurë të anëtarëve të Bordit.”

3. Në nenin 7, shtohet pika 7.6 si më poshtë vijon:

“Vendimet e Bordit, mund të miratohen edhe me një procedurë qarkulluese, në rast se asnjë anëtar nuk shprehet kundër.

Procedura qarkulluese, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, është procedura e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me mjete të tjera komunikimi, pa qenë e nevojshme të thirret mbledhja e Bordit.”